

Selcom Sh.p.k

Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

PËRMBAJTJA:

	FAQE
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	2
PASQYRA E PERFORMANCËS	3
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	4
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	5
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	6 - 22

Selcom Sh.p.k*(Vlerat janë në Lek)***Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2017**

	Shënime	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
AKTIVET			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	3,948,751	2,339,055
Llogari të arkëtueshme tregtare	5	27,653,651	14,664,916
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	6	1,358,022	6,771,449
Të tjera llogari të arkëtueshme	7	4,702,586	4,082,152
Inventari	8	4,695,731	4,641,150
Shpenzime të shtyra	9	2,440,016	1,546,998
Të arkëtueshme nga të ardhura të konstatuara	10	3,007,387	6,058,821
Totali i aktiveve afatshkurtra		47,806,144	40,104,541
Aktivitet afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	11	34,894,584	34,255,264
Aktive afatgjata jomateriale	12	37,228	43,750
Totali i aktiveve afatgjata		34,931,812	34,299,014
Totali i aktiveve		82,737,956	74,403,555
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Hua afatshkurtra	13	7,917,651	2,625,385
Llogari të pagueshme tregtare	14	4,510,716	3,737,508
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	15	274,602	2,942,746
Të pagueshme për shpenzime të konstatuara	16	1,662,924	1,524,240
Detyrime tatimore	17	466,193	2,354,747
Të ardhurat të shtyra	18	60,200	60,200
Të tjera detyrime	19	6,071,054	3,012,768
Totali i detyrimeve afatshkurtra		20,963,340	16,257,594
Detyrime afatgjata			
Hua afatgjata	20	864,752	4,217,033
Llogari të pagueshme nga palët e lidhura	21	5,913,756	15,208,044
Totali i detyrimeve afatgjata		6,778,508	19,425,077
Totali i detyrimeve		27,741,848	35,682,671
Kapitali			
Kapitali i nënshkruar	22	100,000	100,000
Rezerva ligjore		10,000	10,000
Rezerva të tjera		38,610,884	17,608,136
Fitimi i ushtrimit		16,275,224	21,002,748
Totali i kapitalit		54,996,108	38,720,884
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		82,737,956	74,403,555

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e Performancës
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	23	92,708,251	94,440,685
Puna e kryer nga njësia ekonomike e kapitalizuar		3,293,297	2,553,825
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	24	(355,386)	(335,264)
Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme		(60,620,007)	(58,860,432)
1) Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	25	(54,896,504)	(52,575,792)
2) Të tjera shpenzime	26	(5,723,503)	(6,284,640)
Shpenzime të personelit	27	(11,660,424)	(8,881,603)
1) Paga dhe shpërblime		(10,064,419)	(7,687,846)
2) Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetsore		(1,596,005)	(1,193,757)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	11/12	(3,585,830)	(3,612,927)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	28	(115,943)	(6,149)
Të ardhura të tjera		-	-
Shpenzime financiare	29	(458,526)	(478,747)
1) Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme		(576,220)	(815,580)
2) Shpenzime të tjera financiare		117,694	336,833
Fitimi/humbja para tatimit		19,205,432	24,819,388
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	30	(2,930,208)	(3,816,640)
1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		(2,930,208)	(3,816,640)
Fitimi/humbja e vitit		16,275,224	21,002,748
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin:		-	-
Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin		16,275,224	21,002,748

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Selcom Sh.p.k*(Vlerat janë në Lek)*

Pasqyra e ndryshimeve në kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva Ligjore	Rezerva të tjera	Fitim / Humbja e vitit	Totali
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2015	100,000	10,000	6,441,654	11,166,482	17,718,136
Fitimi / Humbja e vitit				21,002,748	21,002,748
Lëvizjet përmes kapitalit			11,166,482	(11,166,482)	-
Pozicioni financiar i rideklaruar më 31 dhjetor 2016	100,000	10,000	17,608,136	21,002,748	38,720,884
Fitimi / Humbja e vitit				16,275,224	16,275,224
Lëvizjet përmes kapitalit			21,002,748	(21,002,748)	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2017	100,000	10,000	38,610,884	16,275,224	54,996,108

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017 u aprovuan dhe u nënshkruan si më poshtë:

Altin Bushka

Altin Bushka
Administrator



Mazars shpk

Mazars shpk
Hartues i Pasqyrave



**Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Flukset e parasë nga aktivitetet operative			
Fitim / Humbja e vitit		16,275,224	21,002,748
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:			
Diferenca këmbimi jo nga aktivitete operative		241,525	(62,472)
Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar			2,069,722
Shpenzime konsumi dhe amortizimi		3,585,830	3,612,927
Rezultati nga shitja e aseteve		(95,200)	(13,503)
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera		(6,037,326)	(5,577,658)
Rënie/(rritje) në inventarë		(54,581)	(1,041,063)
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme		(329,515)	(732,523)
Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit		1,149	3,516
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit		13,587,106	19,261,694
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit			
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale		(4,255,050)	(4,791,722)
Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale		131,622	25,389
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		(4,123,428)	(4,766,333)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit			
Pagesa e huave		(7,494,763)	(14,566,104)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		(7,494,763)	(14,566,104)
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare		1,968,915	(70,743)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar		2,339,055	2,684,162
<i>Efekti i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare</i>		(359,219)	(274,364)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	4	3,948,751	2,339,055

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

“Selcom” sh.p.k (Kompania) është themeluar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar më 18 Korrik 2006 në përputhje me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Kapitali i nënshkruar i shoqërisë është 100,000 Lekë, i ndarë në 100 njësi të barabarta me nga 1,000 Lekë secila.

Ortakët e shoqërisë janë :

- Z. Gentian Sula zotërues i 65 kuotave ose 65% të kapitalit të shoqërisë;
- Z. Altin Bushka zotërues i 35 kuotave ose 35% të kapitalit të shoqërisë;

Aktiviteti kryesor i kësaj shoqërie është ofrimi i shërbimeve të telefonisë, internetit. Projektim dhe zbatim i rrjeteve dhe sistemeve telefonike, rrjeteve dhe sistemeve kompjuterike, sistemeve të vëzhgimit me kamera IP dhe me qark të mbyllur. Import, eksport dhe tregtim me shumicë dhe pakicë të pajisjeve elektronike.

Adresa e selisë së shoqërisë është: Selitë, Tiranë.

Më 31 dhjetor 2017 Shoqëria kishte 16 punonjës (2016: 15 punonjës).

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe amenduar me urdhrin nr.64 datë 22.7.2014 “Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre duke filluar nga 1 janar 2015.

Ky urdhër hyri në fuqi në fletoren zyrtare nr.119 datë 1 gusht 2014.

Kompania përdor formatin e publikuar nga NAS për prezantimin e pasqyrave financiare.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale.

2. Bazat e pregatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)**2.5 Vlerësime dhe gjykime (vazhdim)**

Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga paafësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çrregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%, në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit që mund të masë me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivët dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisht të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2017	2016
Euro/ALL	132.95	135.23
USD/ ALL	111.10	128.17

3. Politikat Kontabël (vazhdim)**3.2. Instrumentat financiarë**

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

(Vlerat janë në Lek)

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiare (vazhdim)

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivitet financiar të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivitet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivitet financiar të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.4. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2017 dhe 2016 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Mobilje dhe orëndi	Vlerë e mbetur	20 %
Pajisje informatike	Vlerë e mbetur	25 %
Ndërtime dhe instalime	Vlerë e mbetur	5%
Makineri dhe pajisje	Vlerë e mbetur	20 %
Automjete	Vlerë e mbetur	20%
Të tjera	Vlerë e mbetur	20 %

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundur që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.7. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.9. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2017 është 15% (2016: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivitet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundur që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

3.10. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.11. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.12. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)**3.13. Aktivet dhe Detyrimet e Kushtëzuara**

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Mjete monetare në bankë	787,217	1,240,940
Llogari rrjedhëse	787,217	1,240,940
Mjete monetare në arkë	3,161,534	1,098,115
	<u>3,948,751</u>	<u>2,339,055</u>

5. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Klientë	27,653,651	14,664,916
	<u>27,653,651</u>	<u>14,664,916</u>

6. Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura

Të arkëtueshmet ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Të tjera të arkëtueshme nga BPO	-	331,653
Të arkëtueshme tregtare nga palët e lidhura	1,358,022	6,439,796
	<u>1,358,022</u>	<u>6,771,449</u>

7. Të tjera llogari të arkëtueshme

Llogaritë e tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Tatim mbi fitimin	288,783	-
Debitorë, kreditorë të tjerë	4,413,803	4,082,152
	<u>4,702,586</u>	<u>4,082,152</u>

8. Inventari

Gjendja e inventarit më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 është si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Lëndë e parë dhe materiale	4,302,874	4,225,662
Mallra për rishitje	392,857	415,488
	<u>4,695,731</u>	<u>4,641,150</u>

9. Shpenzime të shtyra

Shpenzimet e shtyra detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Shpenzime të periudhave të ardhme	670,977	359,984
Parapagime për furnitorët	1,769,039	1,187,014
	<u>2,440,016</u>	<u>1,546,998</u>

10. Të arkëtueshme nga të ardhura të konstatuara

Të arkëtueshmet nga të ardhurat e konstatuara detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Të ardhura të llogaritura nga telefonia	3,007,387	6,058,821
	<u>3,007,387</u>	<u>6,058,821</u>

Selcom Sh.p.k
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Vlerat janë në Lek)

11. Aktive Afatgjata Materiale

	Makineri Pajisje	Automjetet	Mobilje orendi	Paisje kompjuterike	Instrumenta dhe vegla pune	Nderime dhe instalime	Te tjera	Totali
Kosto								
Gjendja më 31 Dhjetor 2015	23,077,049	1,162,988	253,198	2,348,353	62,378	23,388,795	659,550	50,952,311
Shtesa	1,111,169	380,000		109,907	78,000	2,884,105	228,541	4,791,722
Pakësime	(7,455)			(8,750)				(16,205)
Gjëndja më 31 Dhjetor 2016	24,180,763	1,542,988	253,198	2,449,510	140,378	26,272,900	888,091	55,727,828
Shtesa	655,360		13,500	203,917		3,293,297	88,976	4,255,050
Pakësime	(11,420)			(84,603)				(96,023)
Gjëndja më 31 Dhjetor 2017	24,824,703	1,542,988	266,698	2,568,824	140,378	29,566,197	977,067	59,886,855
Amortizimi i akumuluar								
Gjendja më 31 Dhjetor 2015	13,122,644	215,160	196,791	974,971	38,909	3,125,698	196,305	17,870,478
Amortizimi i vitit	1,915,110	202,232	9,168	267,581	15,505	1,082,090	114,719	3,606,405
Pakësime	(1,209)			(3,110)				(4,319)
Gjëndja më 31 Dhjetor 2016	15,036,545	417,392	205,959	1,239,442	54,414	4,207,788	311,024	21,472,564
Amortizimi i vitit	1,778,506	225,119	9,359	258,032	15,804	1,163,934	128,554	3,579,308
Pakësime	(190)			(59,411)				(59,601)
Gjëndja më 31 Dhjetor 2017	16,814,861	642,511	215,318	1,438,063	70,218	5,371,722	439,578	24,992,271
Vlera neto kontabël								
Gjendja më 31 Dhjetor 2015	9,954,405	947,828	56,407	1,373,382	23,469	20,263,097	463,245	33,081,833
Gjendja më 31 Dhjetor 2016	9,144,218	1,125,596	47,239	1,210,068	85,964	22,065,112	577,067	34,255,264
Gjendja më 31 Dhjetor 2017	8,009,842	900,477	51,380	1,130,761	70,160	24,194,475	537,489	34,894,584

12. Aktive Afatgjata Jo Materiale

	AAJM	Total
Me kosto		
Gjendja më 31 Dhjetor 2016	87,476	87,476
Shtesa	-	-
Pakesime	-	-
Gjendja më 31 Dhjetor 2017	87,476	87,476
Amortizimi		
Gjendja më 31 Dhjetor 2016	43,726	43,726
Amortizimi i vitit	6,522	6,522
Kthim amortizimi	-	-
Gjendja më 31 Dhjetor 2017	50,248	50,248
Gjendja Neto më 31 Dhjetor 2016	43,750	43,750
Gjendja Neto më 31 Dhjetor 2017	37,228	37,228

13. Hua aftashkurta

Në këtë zë është paraqitur overdrafti nga bankat më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Overdraft	7,917,651	2,625,385
	7,917,651	2,625,385

14. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Furnitorë vendas	4,494,327	3,679,479
Furnitorë të huaj	16,389	58,029
	4,510,716	3,737,508

15. Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Llogaritë e pagueshme ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Të pagueshme të tjera ndaj palëve të lidhura	-	2,409,990
Të pagueshme tregtare nga palët e lidhura	274,602	532,756
	274,602	2,942,746

16. Të pagueshme për shpenzime të konstatuara

Të pagueshmet për shpenzime të konstatuara më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Shpenzime të konstatuara për telefoninë	1,615,949	1,476,006
Shpenzime të konstatuara të tjera	46,975	48,234
	<u>1,662,924</u>	<u>1,524,240</u>

17. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	190,529	176,370
Tatimi mbi te Ardhurat nga Punësimi	44,793	42,224
Tatim fitimi	-	2,069,722
TVSH për t'u paguar	229,871	64,334
Detyrime doganore	1,000	2,097
	<u>466,193</u>	<u>2,354,747</u>

18. Të ardhura të shtyra

Të ardhurat e shtyra për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Parapagim nga klient	60,200	60,200
	<u>60,200</u>	<u>60,200</u>

19. Të tjera detyrime

Të tjera detyrime për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Paga për t'u paguar	2,483,048	2,481,899
Debitorë dhe kreditorë të tjerë për modema	1,215,886	530,869
Të tjera detyrime	2,372,120	-
	<u>6,071,054</u>	<u>3,012,768</u>

20. Hua afatgjata

Huatë afatgjata për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Kredi ICB	864,752	4,217,033
	<u>864,752</u>	<u>4,217,033</u>

21. Llogari të pagueshme afatgjata ndaj palëve të lidhura

Llogaritë e pagueshme ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Të pagueshme të tjera ndaj ortakëve	5,913,756	15,208,044
	<u>5,913,756</u>	<u>15,208,044</u>

22. Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është në vlerë 100,000 Lekë. Gjate vitit 2017 nuk ka pasur ndryshim në strukturën e kapitalit të shoqërisë.

23. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 detajohen si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
Të ardhura nga telefonia	72,608,470	78,668,483
Të ardhura nga interneti	20,072,657	15,772,202
Të ardhura nga shitja e mallrave dhe shërbimeve	27,124	-
	<u>92,708,251</u>	<u>94,440,685</u>

24. Të ardhura të tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Fitime nga kembimet valutore nga aktiviteti i shfrytëzimit	174,913	183,683
Humbje nga këmbimet valutore nga aktiviteti i shfrytëzimit	(625,499)	(532,450)
Të ardhura nga shitja e aktiveve afatgjata	131,622	25,389
Vlera neto kontabël e aseteve të shitura	(36,422)	(11,886)
	(355,386)	(335,264)

Rakordimi i të ardhurave me deklaratat e TVSH-së dhe Tatim Fitimit.

	31 dhjetor 2017
Rakordimi i të ardhurave me FDP-në	
Shitje total të deklaruara në FDP TVSH	99,869,604
Garanci për modema	(684,999)
Anullim i të ardhurave të 2016 deklaruar në 2017	(6,058,821)
Përllogaritje e të ardhurave të 2016 deklaruar në 2017	3,007,386
Shitje të deklaruar në FDP që janë të ardhura në PASH	96,133,170
Të ardhurat telefoni/internet	92,681,127
Shitje mallra/materiale	27,124
Shitje AQT	131,622
Të ardhura nga prodhimi i AQT	3,293,297
Të ardhura të deklaruara në PASH të cilat janë deklaruar shitje në FDP	96,133,170
Të ardhurat nga interesat	201
Fitim nga këmbimet valutore	292,607
Total të ardhura të deklaruara FDP e Tatim Ftimit	96,425,978

25. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme

Në këtë zë paraqiten kostoja e mallrave, lëndeve të para dhe shërbimeve të konsumuara që lidhen me veprimtarinë e shfrytëzimit. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Kosto e materialeve	4,034,845	3,146,869
Materiale të tjera ndihmëse	1,587,767	1,491,340
Kosto e mallrave të shitur	13,579	-
Nënkontraktorë	49,215,313	47,879,583
Mirëmbajtje centrali	45,000	58,000
	54,896,504	52,575,792

26. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Shpenzime qiraje	1,733,465	1,669,518
Konsulencë ekonomike	1,200,000	1,200,000
Taksa dhe tarifa të ndryshme	989,068	804,953
Komisione bankare	426,982	474,204
Shpenzime administrative	301,330	262,173
Mirëmbajtje dhe riparime	232,943	334,211
Shpenzime të ndryshme dhe të panjohura	177,387	618,727
Shpenzime postare dhe telekomunikacioni	163,547	102,883
Blerje të ndryshme, kancelari etj	142,165	99,183
Shpenzime utilitare	134,109	-
Publicitet, reklama	101,000	-
Siguracione	85,547	39,053
Shpenzime për pritje dhe dhurata	35,960	36,600
Shpenzime transporti, karburant	-	643,135
	5,723,503	6,284,640

27. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
Shpenzime për paga	10,064,419	7,687,846
Shpenzime për sigurime shoqërore e shendetësore	1,596,005	1,193,757
	<u>11,660,424</u>	<u>8,881,603</u>

28. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit paraqesin gjobat dhe penalitetet për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
Gjopa dhe penalitete	115,943	6,149
	<u>115,943</u>	<u>6,149</u>

29. Shpenzime financiare

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit dhe rezultatin nga kursi i këmbimit që lidhet me aktivitetin financiar të shoqërise. Ky zë detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
Shpenzime për interesa	(576,421)	(815,716)
Të ardhura nga interesat	201	136
Humbje nga këmbimet valutore	-	(75,896)
Të ardhura nga këmbimet valutore	117,694	412,729
	<u>(458,526)</u>	<u>(478,747)</u>

30. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Përlllogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
<i>Fitimi para tatimit</i>	19,205,432	24,819,388
Shpenzime të panjohura të tjera (si më poshtë):	329,290	624,876
Penalitet, gjoba e dëmshpërblime	115,943	6,149
Shpenzime të tjera	213,347	618,727
<i>Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)</i>	<u>19,534,722</u>	<u>25,444,264</u>
<i>Tatim fitimi 15%</i>	<u>2,930,208</u>	<u>3,816,640</u>
	<u>16,275,224</u>	<u>21,002,748</u>

31. Transaksionet me palët e lidhura

Balancat me palët e lidhura më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2017</u>	<u>31 Dhjetor 2016</u>
Bilanci kontabël		
Të pagueshme ndaj palët e lidhura		
S&D Invest	274,602	274,602
Agi Kons		557,339
Albdesign Shpk		2,110,805
Gentian Sula	3,740,117	13,075,951
Altin Bushka	2,173,639	2,132,093
	<u>6,188,358</u>	<u>18,150,790</u>
 Të arketueshme nga palët e lidhura		
BPO Solution		331,653
S&D Invest Sha	1,358,022	660,943
Agi Kons		4,723,915
Albdesign Shpk		1,054,938
	<u>1,358,022</u>	<u>6,771,449</u>

Selcom Sh.p.k
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
(Vlerat janë në Lek)

Detajet e transaksioneve me palët e lidhura gjatë vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve		
Shitje palëve të lidhura		
S&D Invest Sha	789,233	431,776
Agi Kons		660,101
Albdesign Shpk		80,824
	<u>789,233</u>	<u>1,172,701</u>
Blerje nga palët e lidhura		
S&D Invest Sha	227,065	174,658
Agi Kons		414,765
Albdesign Shpk		658,900
	<u>227,065</u>	<u>1,248,323</u>

Politika e vendosjes së çmimeve për transaksionet me palët e lidhura bëhet në bazë të kushteve të tregut.

24. Angazhime dhe pasiguri

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të kenë efekt negativ në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj.

Më 31 Dhjetor 2017, shoqëria nuk ka angazhime kapitale të kontraktuara por ende të papaguara.

25. Ngjarje pas bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit që kërkojnë rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.